



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 09.07.2025
Numër Protokolli: 4678/2025

A.nr.877/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Rushit Kajtazi në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.877/2025 të datës 14.05.2025 të parashtruar nga ankuesi Q.M, kundër organit të punësimit/ Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, në çështjen juridike “ Kompensim material, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 09.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa A.nr.877/2025 e datës 14.05.2025, e parashtruar nga ankuesi Q.M.

A r s y e t i m

Ankuesi Q.M(në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), i punësuar në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë më datë 14.05.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3150/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr. 877/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor me arsyetimin se Sekretari i Përgjithshëm me vendim me ref. Zsp me numër protokolli 655/11 përmes të cilit vendim me lejohet ngritja e koeficientit nga koeficienti 8, në koeficient 8.5, për arsye të angazhimit dhe kryerjes së punëve shtesë dhe në zbatim të këtij vendimi me ndryshohet edhe akt emërimi me datë 12.09.2011, me koeficient 8.5, pastaj nga data 01.10.2012, gjeri me datë 26.07.2014, jam caktuar në vendin e punës Koordinator i Inspektoreve, dhe nga data 12.01.2017, posedoj akt emërimin për vendin e punës Koordinator i Inspektoreve, me koeficient 8, dhe së që kjo kohë edhe para vitit 2017, ku Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe Projekti i Bankës Botërore, në vitin 2012 pat dhënë fond për financimin e projektit të përbashkët unë kam ushtruar detyrat e udhëheqësit të Inspektoreve dhe se pas përfundimit të projektit nga Banka Botërore, kam

vazhduar dhe jam udhëheqës, edhe sot e kësaj ditë kam vazhduar t'i kryej detyrat e njëjta dhe nuk paguhem me koeficient 8.5, por me koeficient 8, me tej ankuesi ka konstatuar se me datën 23.01.2025, kam parashtruar kërkesë tek organi i punësimit, por organi punëdhënës nuk më ka kthyer përgjigje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.05.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, ndërsa Këshilli më datën 13.06.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, me shkresat e bashkangjitura.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 4288/2025, të datës 23.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr. 877/2025, të parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën e ankuesi Q.M.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokolli 3150/2025 të datës 14.05.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 02.02.2009, për Q.M; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 02.02.2010, për Q.M; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.09.2011, për Q.M; Vendimi me numër protokolli 2963, i datës 12.09.2011, i nxjerr Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 01.10.2014, për Q.M; Akt Emërimi me numër protokolli 52, i datës 12.01.2017, për Q.M; Plani individual i punës për vitin 2023; Plani individual i punës për vitin 2024; Kërkesë me numër protokolli 495, e datës 23.01.2025, drejtuar Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 19.05.2025, dërguar nga R.K ,për M.B; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 877/2025, e datës 13.06.2025; Vendimi me numër protokolli 1801, i datës 18.03.2025, i nxjerr nga Drejtori Ekzekutiv i AZHB- së; Vendimi me numër protokolli 4288/2025, i datës 23.06.2025, i Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 14.05.2025 **është e pas afatshme**, sepse:

Nga provat e lëndës rezulton se ankuesi, sipas Akt Emërimit me numër protokoll 52 të datës 12.01.2017, mbanë pozitën ‘‘ Koordinator i Inspektorëve’’, në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar më datë 14.05.2025 thekson se më datë 23.01.2025 kam parashtruar kërkesë tek organi i punësimit, respektivisht Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë, mirëpo organi punëdhënës nuk është përgjigjur në kërkesën time, prandaj në ankesën e parashtruar në KPMSHCK pretendon se i takon kompensimi me koeficiente 8.5.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërin e ankesës, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Shërbimin Civil përkatësisht nenit 27, paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i civil ka të*

drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil., si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: “1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”, në këtë rast, në kuptim të nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të, ku përcaktohet se: “1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”, organit të cilit i është drejtuar kërkesa është dashur të vendos brenda afatit prej 45 ditësh apo të aplikohet neni 99 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo meqë kërkesa e palës ankuese nuk është shqyrtuar, atëherë është aplikuar heshtja administrative. Sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast se organi publik hesht ndaj kërkesës së palës, atëherë palës i lind e drejta që të parashtroj ankesë tek organi i shkallës më të lartë për heshtje administrative duke u bazuar në dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse organi i punësimit ka heshtur ndaj Kërkesës me numër protokolli 495 të datës 23.01.2025, të parashtrua nga ankuesi Q.M, ankesa e parashtruar me datë 14.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pa pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht referuar kuadrit ligjor përkatës Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi, me datë 14.05.2025 është e pasafatshme, ngase sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi më datë 23.01.2025, ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 495, tek organi i punësimit, ndërsa ankesën e ka parashtruar në KPMSHCK e ka parashtruar jashtë afatit ligjor sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 127 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 877/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Q.M;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së